

UNIVERSITETI I PRISHTINËS "HASAN PRISHTINA"

FAKULTETI EKONOMIK



**NDIKIMI I FAKTORËVE TË FIRMËS DHE MJEDISIT
INSTITUCIONAL NË ZHVILLIMIN E INOVACIONIT TË
QËNDRUESHËM**

AGNESË IBRAHIMI

2024

Abstrakt

Inovacioni i qëndrueshëm mbetet një nga temat kryesore në debatet akademike dhe politike. Ky studim shqyrton se si karakteristikat e firmës ndikojnë në inovacionin e qëndrueshëm në vendet evropiane dhe jo-evropiane, duke marrë parasysh kontekstet e ndryshme institucionale. Duke u mbështetur në teorinë institucionale dhe duke shfrytëzuar të dhënat nga sondazhi i Eurobarometrit 2020 që përfshin 15,000 intervista në 36 vende evropiane dhe joevropiane, analiza ekonometrike në shumë nivele e individëve në këto vende zbulon një lidhje të fortë midis inovacionit të qëndrueshëm dhe faktorëve specifik të firmës si dhe cilësisë institucionale. Ne kombinojmë të dhënat në nivel firmash nga Eurobarometri 2020 me burime të tjera të të dhënave në nivel vendi për të matur cilësinë institucionale dhe inovacionin e qëndrueshëm. Për këtë qëllim, përdorim një model regresioni logjistik me shumë nivele, i cili shfrytëzon natyrën hierarkike të të dhënave për të analizuar lidhjet ndërmjet këtyre faktorëve, dhe ofron një pasqyrë të qartë të faktorëve që nxisin inovacionin e qëndrueshëm. Gjetjet tregojnë se ndërmarrjet e vogla dhe të mesme priren të zhvillojnë inovacione më të qëndrueshme dhe vendet me cilësi të lartë institucionale dhe besim institucional nxisin një mjedis të favorshëm për inovacion të qëndrueshëm. Punimi përfundon me implikimet për teorinë dhe politikën, duke sugjeruar se si qeveritë mund të luajnë një rol të rëndësishëm në rritjen dhe zhvillimin e inovacionit të qëndrueshëm.

Inovacioni është pjesë e pandashme e secilit entitet ndërmarrës. Inovacioni është ajo çfarë bënë diferencimin e një biznesi të suksesshëm. Megjithatë, sot vetëm termi inovacion po del të jetë i mangët nëse nuk i shtohet edhe fjala i qëndrueshëm. Inovacioni i qëndrueshëm është një proces që përfshin zhvillimin dhe përdorimin e teknologjive dhe ideve të reja, duke pasur një ndikim pozitiv në mjedis, shoqëri dhe ekonomi. Ndryshimet klimatike, keqpërdorimi i burimeve natyrore dhe shkatërrimi i mjedisit janë disa nga arsyet që kanë shtyrë bizneset të kuptojnë se çdo përfitim që është në dëm të të mirave sociale do të kthehet një ditë si një bumerang, duke çuar në dështim. Biznesi duhet të kuptoj se jo vetëm përfitimet personale kanë rëndësi, kur ndërkohë këto përfitime të një individi mund të çojnë rreth shkatërrimit grupor të një shoqërie. Inovacioni i qëndrueshëm është një përpjekje thelbësore për të adresuar sfidat e kohëve

moderne dhe për të siguruar një të ardhme të qëndrueshme për brezat e ardhshëm.

Përmes këtij punimi të doktoratës, studiohet nga afër rëndësia që organizatat e ndryshme në tregjet evropiane i kushtojnë krijimit të inovacioneve, duke marrë parasysh përgjegjësinë sociale ndaj mjedisit, njerëzve dhe natyrës. Ky studim është një fushë relativisht e re, e cila nuk përqendrohet më vetëm në aspektin e krijimit të inovacioneve, por kalon në një nivel krejtësisht të ri, duke theksuar krijimin e inovacioneve të qëndrueshme që rrisin përgjegjësinë sociale të biznesit ndaj shoqërisë dhe mjedisit.

Fjalët kyçe: inovacioni i qëndrueshëm; faktorët institucional; faktorët e firmës;